



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA GRAMSH**

**RELACION TEKNIK**

**Objekti:** “Rikontruksion i zyrave të Këshillit Bashkiak dhe zyrave të katit të parë të bashkisë Gramsh”(ndryshim funksioni midis zyrave)”

**Të përgjithshme**

Ky objekt përfshin rikontruksionin dhe përshtatjen e zyrës së Këshillit Bashkiak që ndodhet pranë N/ Prefekurës së qytetit të Gramshit. Është ideuar që ambienti të ndahet në dy zyra, përkatësisht, zyra e Sekretarit të Këshillit Bashkiak e cila do të zhvendoset nga godina e bashkisë, si dhe salla e Këshillit. Gjithashtu është projektuar dhe rikontruksioni dhe përshtatja e zyrave të bashkisë Gramsh, duke kryer një ndryshim funksioni midis zyrave. Bashkia Gramsh ka hartuar projektin dhe kërkon ta implementojë atë duke synuar shndërrimin e këtyre ambienteve në një mjedis të përshatshëm, të pajisur me gjithë infrastrukturën e duhur për të qënë sa më transparent, si dhe për të siguruar pjesëmarrje të gjerë të komunitetit gjatë vendimarrjes së Këshillit Bashkiak. Duke qënë se disa prej ambienteve në këtë kat zhvendosen, si dhe duke marrë parasysh hapësirën e pamjaftueshme të zyrës së Kryetarit të Bashkisë për të kryer mbledhjet me punonjës të administratës apo delegacione të huaja apo vendase lind nevoja për të kryer përshtatshmërin e këtyre zyrave.

**Gjendja aktuale**

Aktualisht, këto ambiente ndodhen në kushte të papërshtashme për të kryer funksionet e tyre, për shkak të hapësirave të pamjaftueshme për zhvillimin e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë, ku marrin pjesë edhe nëpunësit e administratës apo qytetarët.

**Përshkrimi i punimeve**

Në këtë projekt janë përfshirë punimet e ndërtimit si më poshtë :

1. Punime prishje mur tulle, mure betoni, prishje shtresash pllaka dysheme dhe heqje suvaje nga tavanet e muret.

2. Punime ndërtimore që konsiston në suvatim mure dhe tavane, shtresë pllakash greiz importi dhe parket laminat, patinime muresh dhe tavanesh, prigje mermari në dyer, lyerje me boje hidroplastike brenda ( mur + tavan ) si dhe furnizim vendosje dyer të brendshme .
3. Punime elektrike janë përfshirë ndriçuesa dekorativ fluorishent, ndriçuesa led ekonomik, kuti shpërndarëse plastike, furnizim vendosje çelsa dhe priza.
4. Punime hidrosanitare janë të përfshira të gjitha pajisjet hidrosanitare të përcaktuara sipas projekt – preventivit.
5. Mobilimi i zyrave.

**HARTOI**

**Ing. Eva ISMAILAJ**

